

VENDIM
Nr. 13/2018

**PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT “PËR TË DREJTAT E NJERIUT”, NË
PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR ÇËSHTJET
LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet nënkomisioni “Për të drejtat e njeriut”, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Fusha e përgjegjësisë së këtij nënkomisioni janë të drejtat e njeriut.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë:

1.	Vasilika Hysi	Kryetare	(PS)
2.	Enkelejd Alibeaj	Zëvendëskryetar	(PD)
3.	Xhemal Qefalia	Anëtar	(PS)
4.	Eglantina Gjermeni	Anëtare	(PS)
5.	Jurgis Çyrbja	Anëtar	(PS)
6.	Edmond Panariti	Anëtar	(LSI)
7.	Oerd Bylykbashi	Anëtar	(PD)

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 1.2.2018